



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Prishtinë 10/07/2019

## Termet e referencës Ekspert për sigurinë në ushqim

### Qëllimi i angazhimit të ekspertit afatshkurtër të jashtëm

Zyra Kombëtare e Auditimit është në proces të auditimit të performancës “**Siguria në ushqim**”. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti të auditimit është vlerësimi funksionimit të zinxhirit ushqimor që lidhet me planifikimin dhe inspektimet e sigurisë ushqimore nga importi dhe prodhimi apo përpunimi brenda vendit dhe gjatë kohës që ky produkt është në qarkullim në tregun e brendshëm.

Për shkak të fushës dhe njohurive specifike që kërkohen për kryerjen e këtij auditimi, Zyra Kombëtare e Auditimit kërkon angazhimin e ekspertit të sigurisë në ushqim.

Kohëzgjatja e angazhimit është 10 ditë pune.

### Përshkrimi i punës dhe detyrat kryesore të Ekspertit për Sigurinë në Ushqim

Eksperti për sigurinë në ushqim duhet të përkrahë ekipin e auditimit për vlerësimin dhe interpretimin e të rezultateve dhe të dhënave të mbledhura nga entitetet e audituara (Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe në Drejtoritë e Inspektoratit Komunal, Komuna e Vushtrrisë dhe Komuna e Gjilanit).

Eksperti gjatë angazhimit koordinohet në menyrë të plotë dhe vepron sipas kërkesave të ZKA-së dhe ekipit të auditimit.

Eksperti duhet të përkrahë ekipin me udhëzimet dhe ekspertizën në vlerësimin e mostrave të auditimit të cilat përmbajnë të dhëna komplekse sikurse llojin e analizave të marra nga inspektori dhe kategorizimin e tyre.

Eksperti po ashtu duhet të ofrojë ekspertizën rreth standardeve (vendore dhe nderkombëtare) për sigurinë në ushqim si dhe në ofrimin kontributit rreth praktikave të mira në sigurinë e ushqimit dhe krahasimin e tyre me praktikën aktuale në vend, duke rekomanduar përmirësime për mangësitë që identifikohen.

Ndër të tjera, përgjegjësi të ekspertit janë:

- Të ofrojë ekspertizën e duhur lidhur me sigurinë e ushqimit dhe vlerësoj planin e inspektimit dhe metodat e përdorura nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë për numrin e inspektimeve dhe mostrave brenda vitit;
- Të vlerësojë dhe ofroj raport mbi gjendjen e sigurisë së ushqimit bazuar në dëshmitë e mbledhura nga ekipi auditues;
- Të kryej analiza të nevojshme për rastet e studimit (produktet e mishit dhe grurit):

- Prezenca e ekspertit është e nevojshme gjatë fazës së ekzekutimit të auditimit dhe raportimit;
- Puna e ekspertit duhet të përshtatet kërkesave dhe standardeve që aplikohen ZKA po ashtu rezultatat e punës (gjetjet) duhet nderlidhur me dëshmi të mjaftueshme dhe relevante;
- Të ofrojë ekspertizën rreth standardeve (vendore dhe ndërkombëtare) për sigurinë në ushqim;
- Të veprojë në përputhje me rregullat dhe kodin e etikës që aplikohet në ZKA; dhe
- Të jetë i gatshëm t'i përgjigjet kërkesave të tjera që mund të dalin nga faza e ekzekutimit (puna në teren) dhe që konsiderohen të nevojshme për nevojat e auditimit siç janë pjesëmarrja në takime me ekipin, me palët e audituara, si dhe komunikimi i vazhdueshëm me ekipin e auditimit.

### **Përgatitja e raportit**

Raporti i Ekspertizës do të fokusohet në prezantimin e të dhënave dhe analizave mbështetëse në një vëllim të veçantë, nëse është e nevojshme. Duhet të përfshijë një përmbledhje ekzekutive që diskuton shkurtimisht gjetjet e rëndësishme dhe veprimet e rekomanduara. Struktura e sugjeruar e raportit është e përshkruar më poshtë:

- Përmbledhja e përgjithshme;
- Qasja dhe metodologjia e përdorur;
- Politikat, ligjet, rregulloret, standardet;
- Analizat e kryera;
- Ndikimet potenciale mjedisore dhe në automjete;
- Konkluzionet dhe rekomandimet.

### **Kërkesat e punës**

Eksperti për sigurinë në ushqim duhet të ketë edukimin relevant të diplomuar në drejtimet si Teknologji Ushqimore, Biologji apo Kimi.

Po ashtu është e preferueshme që eksperti të posedojë njohuri dhe trajnime adekuata në fushën e sigurisë së ushqimit, specifikisht për standardin ISO/22000:2018 për sistemit e menaxhimit të sigurisë në ushqim dhe kërkesat për secilën organizatë që merret me zinxhirin ushqimor.

Eksperti duhet të ketë 5 vite përvojë pune në fushën ushqimit apo të ngjashme.

Përparësi kanë kandidatët që deshmojnë njohuri rreth kërkesave për sigurinë e ushqimit që plasohet në treg, në veçanti të jetë i/e aftë të interpretojë të rezultatet e analizës së procesverbaleve dhe analizave të kryera nga inspektorët në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Kandidatët e interesuar duhet të bashkëngjisin këto dokumente:

- Letër Motivuese;
- Biografi (CV);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dëshminë për studimet universitare;
- Dëshmitë mbi përvojën e punës në fushën përkatëse; Kopjet e trajnimeve relevante të kryera (nëse ka); dhe
- Referencat apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatin që aplikon.